

## **PROCESVERBAL**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime Mirembajtje Objekte Ndertimore”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45261920-9 - Mirëmbajtje çatie, 45410000-4 - Suvatim, 45442110-1 - Lyerje ndërtesash**

**VLERA E FONDIT LIMIT: . 2,666,666 (Dy milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Has** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo me vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 55 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi

**2.2.2** Kopje e vertetuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023) të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet, *ku të paktën në dy bilance të njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

*Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023 si dhe kestet e maturuara për vitin 2024. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 55 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

*Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Për të provuar përvojën e meparshme kerkohen:**

**a Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë sa 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, si dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

**b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është sa vlera limit e kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudit, certifikaten e marrjes ne dorezim te perhershem dhe faturat tatimore perkatese me entet publike ose fatura tatimore dhe kontrata bashkepunimit me ente private.

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë formulari i vleresimit i shoqeruar me: Kontraten e punimeve; Lejen e ndertimit dhe te shfrytezimit leshuar nga njesia vendore perkatese; Situacionin perfundimtar si dhe faturat tatimore per çdo situacion.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 “Procedure e hapur e thjeshtuar”, pika 4 \ a , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik:*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se **20 (Njete)** punonjeshish, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

***Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **Drejtues Teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Elektracist**

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin teknik**, si më poshtë

**- 1 (një) teknik ndërtimi**

te cilet duhet te figurojë ne Listëpagesa te pakten për 3 muajt e fundit, per te cilet duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- diploma përkatëse

***Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Kjo kerkese eshte hartuar mbi bazen e parashikimeve te VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas te ciles, “Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që jane është/jane përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Ne rastin konkret, ne projekt-preventivin jane parashikuar punimet që do të kryhen dhe per realizimin e tyre jane kerkuar inxhinieret sipas profileve dhe profesioneve perkatese. Numri i tyre eshte bere nisur nga sasite e punimeve ne preventive dhe natyren e objektit te kesaj kontrate. Inxhinieri elektrik eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve

elektrike te parashikuara ne preventivin e punimeve. Inxhinieri i ndertimit eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve te tjera te ndertimit te parashikuara ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë te pakten 8 punonjes te kualifikuar, nga te cilet: 2 punonjës suvatues, 2 punonjes bojaxhi, 2 punonjes elektrikist , 2 punonjes hidroizolues të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve,

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë sipas kodit përkatës te profesionit.
- *Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:*

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat i leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
.....				

## **Manovrator 2 (dy)**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
  - (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor.
- **Për manovratorët te cilet shoqëria i puneson nepermjet kontraktimit (mjetet me qera) punonjesit nuk do te kerkohen ne listepagesat e shoqerise.**

*Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, nuk ka nevojë që të figurojnë në listepagesat përkatëse të O.E. ofertues.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit (përvec tabelës së mesipërme e cila duhet të paraqitet e plotësuar gjatë fazës së ofertimit), sipas Shtojcës 8*

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar preventivit të punimeve është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë të paktën 2 manovratore për realizimin e zërës të punimeve gërmim dhe me eskavator etj.

Gjithashtu është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë personel të kualifikuar 2 punonjës bojaxhi për realizimin e zërës të punimeve Sherbet e bojatisje me gelqere, Boje hidroplastike importi çilesi e I-re etj., 2 punonjës elektrikist për realizimin e zërës të punimeve F.V percjelles PPV, Ø 2 x 1.5 mm<sup>2</sup>, F.V Çelesa e priza 10 A, F.V Portollampa normale 10 A etj., 2 punonjës hidroizolues për realizimin e zërës të punimeve Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtresë k katrama.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**-NP-3 A (Rikonstruksion dhe mirembajtje godine...)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në klasifikimin e niveleve (germave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Në çdo rast, për secilën kategori licence, është përcaktuar niveli (germa) A duke u nisur nga vlera e punimeve në parashikuara në preventiv dhe/apo në specifikimet teknike.

Kategoria e licences NP – 3 A është kërkuar nga autoriteti kontraktor pasi është parashikuar realizimi i zërës të punimeve për rikonstruksionin dhe mirembajtjen e objekteve arsimore.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuiivalentin e saj
- OHSAS 45000 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuiivalentin e saj
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” ose ekuiivalentin e saj.

Çertifikatat kërkohej të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi shoqërorish çdo anëtar i bashkimit të shoqërive duhet të zotërojë certifikatat e mesipërme në raport me përqindjen dhe zërat e preventivit që merr pjesë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri dhe pajisje	Njesia	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 10 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Autovinc	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Vibrator	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Pompë uji	cope	1	Ne pronesi ose me qera

Motogjenerator / Gjenerator	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Depozite uji 2000 litra	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine deri ne 3.5 Ton	cope	2	Ne pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	cope	1	Ne pronesi ose me qera
Kokore	cope	15	Ne pronesi ose me qera
Jelek	cope	15	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	cope	5	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	cope	3	Ne pronesi ose me qera

a. Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet :

1. Leje qarkullimi
2. Certifikaten e kontrollit teknik
3. Police sigurimi
4. Leje trasporti

b. Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

1. Leje qarkullimi
2. Certifikaten e kontrollit teknik
3. Police sigurimi
4. Leje trasporti per vete dhe te trete

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Eshte kerkuar mjeti “Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 10 ton” per realizimin e transportit te mallrave dhe materialeve te ndertimit.



Eshte kerkuar mjete "Kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton" per realizimin e transportit te mallrave dhe materialeve te ndertimit.

Eshte kerkuar mjete "Autovinc" per realizimin e zerave te preventivit punime ne lartesi dhe per transportimin e bazes materialeetj.

Eshte kerkuar "Vibrator" per realizimin e vibrimit te betoneve.

Eshte kerkuar "Pompë uji" per realizimin e furnizimit me uje.

Eshte kerkuar "Pompë suvatimi" per realizimin e suvase.

Eshte kerkuar "Motogjenerator / Gjenerator" per realizimin e zerave te punimeve.

Eshte kerkuar "Depozite uji 2000 litra " per realizimin e furnizimit me uje per realizimin e punimeve.

Kamioncine deri ne 3.5 Ton per realizimin e zerave te punimeve meqense punohet ne disa objekte njekohesisht dhe per nje afat prej 30 ditesh..

**Operatori/et ekonomike ofertues për materialet** Boje hidroplastike, percjelles PPV, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog, certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar, Iso 9001 nga prodhuesi ose deklarata e konformitetit CE.

Te paraqitet grafiku i punimeve i detajuar.

**Argumentimi:** Paraqitja e ketyre dokumenteve eshte vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes se artikujve te sipercituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e

tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 *“Kërkesat e cilësisë”* të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të*

*drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

**Afati per realizimin e punimeve eshte 30 dite.**